

HYRJAKRYESOREAKTUALITETPOLITIKËNË
OPINIONUNË
SHKRUAJRAJONIBOTASPORTINSTABIZLIFE
STYLE

EMISIONET

Kronikë


Plagosi kunatin pas aksidentit në Vlorë, arrestohen 4 persona



Bëhu pjesë e Grupit Zyrtar të Opinion.al
>> KËTU <<

PLOTËSO
SOT CDO
DËSHIRË!

- Kreditim deri në **2,000,000 LEK** pa kolateral
- Kreditim deri në **500,000 LEK** pa garantor
- Procedura të shpejta **aprovimi**



PLOTËSO
SOT CDO
DËSHIRË!

- Kreditim deri në **2,000,000 LEK**
- Kreditim deri në **500,000 LEK**
- Procedura të shpejta a

JAGUAR



Publikuar në : 15:23 - 18/11/19 |

Policia ka arrestuar katër persona të cilët janë përfshirë në
pajtimin e ndodhur ditën e dielme në Vlorë. Mësohet se pas

Sipas të dhënave aksidenti ka ndodhur në aksin rrugor Levan-Vlorë pranë një karburanti, ku Miri Tefai ka qëlluar në ajër me armë zjarri dhe aksidentalisht ka plagosur kunatin e tij, 25-vjeçarin Engli Nake, cili aktualisht ndodhet në spitalin e Vlorës ku po merr mjekimin e nevojshëm mjekësor.

Përveç personave të përfshirë në konflikt, policia ka arrestuar dhe rojen e karburantit duke e akuzuar atë për “Moskallëzim krimi”.

Njoftimi

Policia zbardh ngjarjen e ndodhur gjatë natës në aksin rrugor Levan-Vlorë, ku gjatë një konflikti për përplasje të mjeteve mbeti aksidentalisht i plagosur më armë zjarri një shtetas. Vihen në pranga 4 shtetas. Mbrëmjen e kaluar, në Spitalin Rajonal Vlorë ka shkuar i plagosur me armë zjarri shtetasi E. N., 25 vjeç, banues në fshatin Ferras, Fier.

Menjëherë pas veprimeve hetimore të kryera nga një grup i posaçëm hetimor për zbardhjen e ngjarjes ka rezultuar se në aksin rrugor pranë mbikalimit të Levanit janë përplasur automjetet Volskëagen Golf, me drejtues shtetasin E. B., e pasagjerë shtetasit E. Y. dhe Xh. T dhe Alfa Romeo, me drejtues shtetasin M. T. e pasagjerë shtetasit S. Q. dhe E. N.

Këta të fundit, në tentativë për t'u larguar me mjetin e tyre nga vendi i ngjarjes në drejtim të Vlorës janë ndjekur nga 3 shtetasit e tjerë me Volskëagen Golf dhe ka nisur konflikti midis tyre në mbikalimim e Novoselës, pranë një karburanti, ku si pasojë, duke qenë edhe nën efektin e pijeve alkoolike, dyshohet se shtetasi M. T. ka qëlluar në ajër me armë zjarri dhe aksidentalisht ka plagosur kunatin e tij shtetasin E. N., i cili ndodhet në Spitalin Rajonal Vlorë, jashtë rrezikut për jetën.

Grupi i posaçëm hetimor, në vijim të punës intensive për zbardhjen e ngjarjes bëri dokumentimin e plotë të saj, duke arrestuar në flagrancë për veprat penale “Plagosja e rëndë me dashje”, “Armëmbajtja pa leje”, “Kanosja”, “Drejtimi i mjetit në gjendje të dehur” dhe “Largimi nga vendi i aksidentit”, shtetasit:

- M. T., 41 vjeç, banues në Vlorë, S. Q., 20 vjeç dhe E. N., 25 vjeç, banues në Ferras, Fier.

Gjithashtu, Policia ka arrestuar në flagrancë për “Moskallëzim Krimi” shtetasin E. K., 27 vjeç, banues në Zharrës, Fier,

<https://opinion.al/plagosi-kunatin-pas-aksidentit-ne-vlore-arrestohen-4-persona/>



Artikull joetik?

raporto këtu

TË FUNDIT

COVID/Greçia regjistron 4 raste me variantin e ri, humbin jetën 49 persona



18:20 - 08/01/21

Përmbytjet në vend, FA dyfishon kapacitetet në ndihmë të banorëve



18:17 - 08/01/21

Ndërroi jetë si pasojë e COVID, 21-vjeçari vuante nga sëmundje të tjera



punonjës (roje) pranë karburantit ku ndodhi përplasja.

Materialet do t'i referohen Prokurorisë në ngarkim të tyre, për veprime të mëtejshme./ Opinion.al



17:58 - 08/01/21

Ju sugjerojmë



14:20 - 08/01/21

Operacioni anti-drogë, arrestohet dhe personi i shpallur në kërkim



13:15 - 08/01/21

Operacioni anti-drogë, Policia: 7 muaj hetime, ekzekutohen 22 masa sigurie



11:04 - 08/01/21

Operacion anti-drogë, SPAK lëshon 23 urdhër arreste




17:47 - 08/01/21

Rama pritet për drekë në shtëpinë e Mitsotakis, kush i shoqëronte liderët



09:25 - 08/01/21

Trafikoi sasi të madhe hashashi drejt Italisë, pranga të riut në Tiranë



09:00 - 08/01/21

Përplasi për vdekje efektiven e sigurisë portuale, arrestohet shoferi



17:25 - 07/01/21

Sekuestrohen 50 mijë euro në Kakavijë, fieraku i kishte fshehur në valixhe




17:30 - 08/01/21



16:48 - 07/01/21

FOTO/ Përmbytje e rrëshqitje dherash, bllokohet rruga Sarandë- Gjirokastër



16:05 - 07/01/21

Grabitja në Rinas/ Alkond Bengasi tërhiqet nga bashkëpunimi me drejtësinë



14:09 - 07/01/21

Nuk zbatuan masat antiCOVID-19, policia gjoi 427 qytetarë

